

Shënime hyrëse dhe lista e operacioneve të punimit ose përpunimit thelbësor që japin origjinë jo-preferenciale

SHËNIME HYRËSE

1. Përkufizime

- 1.1. Referencat për 'fabrikim', 'prodhim' ose 'përpunim' të mallrave përfshin të gjitha operacionet e punimit, montimit ose përpunimit.

Metodat e përfutimit të mallrave përfshijnë fabrikimin, prodhimin, përpunimin, shtimin, rritjen, shumimin, nxjerrjen nga toka, ekstraktimin, vjeljen, peshkimin, kapjen përmes kurtheve, grumbullimin, mbledhjen, gjuetinë dhe kapjen.

- 1.2. 'Material' përfshin përbërësit, pjesët, komponentët, nënpjesët dhe mallrat që janë përfshirë fizikisht në një mall tjetër ose që i janë nështruar një procesi për të prodhuar një mall tjetër.

'Material origjinues' do të thotë një material, vendi i origjinës së të cilit, siç është përcaktuar në këto rregulla, është i njëjti vend ku materiali është përdorur për prodhim.

'Material jo-origjinues' do të thotë një material, vendi i origjinës së të cilit, siç është përcaktuar në këto rregulla, nuk është i njëjti vend në të cilin materiali është përdorur për prodhim.

'Produkt' do të thotë produkti që është fabrikuar, edhe kur është për qëllim përdorimi të mëvonshëm në një operacion tjetër fabrikimi.

- 1.3. Rregulli i vlerës së shtuar

- (a) 'Rregulli i vlerës së shtuar i X%' do të thotë fabrikim ku vlera e përfutuar si rezultat i punimit dhe përpunimit, si dhe nëse përfshihen pjesë origjinuese nga vendi i fabrikimit, paraqet të paktën X% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit. 'X' përfaqëson përqindjen e treguar për çdo kre.

- (b) 'Vlera e përfutuar si rezultat i punimit dhe përpunimit si dhe përfshirjes së pjesëve origjinuese të vendit të fabrikimit' do të thotë shtim i vlerës si rezultat i operacioneve të bashkimit, këtu përfshirë çfarëdoj operacioni përgatitor, të përfundimit dhe kontrollit, si dhe nga përfshirja e pjesëve origjinuese nga vendi ku janë kryer operacionet në fjalë, përfshirë fitimin dhe kostot e përgjithshme të krijuara në atë vend si rezultat e operacioneve.

- (c) 'Çmimi i fabrikës/ex-works' do të thotë çmimi i paguar ose që duhet paguar për produktin e gatshëm të përfutuar në mjediset e fabrikës ku kryhen proceset e punimit dhe përpunimit të fundit; ky çmim duhet të reflektojë të gjitha kostot e lidhura me fabrikimin e produktit (përfshi koston e të gjitha materialeve të përdorura), minus taksat e brendshme të cilat janë, apo mund të jenë rimbursuar kur produkti i përfutuar eksportohet ose rieksporthet.

Aty ku çmimi aktual i paguar nuk reflekton të gjitha kostot e lidhura me fabrikimin e produktit të cilat realisht kanë lindur, çmimi i fabrikës/ex-works nënkupton shumën e të gjitha këtyre kostove, minus taksat e brendshme që janë, ose mund të jenë, rimbursuar kur produkti i përfutuar është eksportuar ose rieksportuar.

- 1.4. Konfeksionim i plotë

Në listë me termin 'konfeksionim i plotë' dotë nënkuptohen të gjitha operacionet që duhen kryer në vijim të prerjes së pëlhurave ose dhënies së formës drejtpërdrejt nga thurja. Megjithatë, konfeksionimi nuk duhet konsideruar domosdoshmërisht si i papërfunduar kur një apo më shumë operacione përmbyllëse nuk janë kryer.

- 1.5. Aty ku termi 'vend' përdoret në këtë Aneks, duhet kuptuar se i referohet 'vend ose territor'.

2. Zbatimi i rregullave në këtë Aneks

- 2.1. Rregullat e dhëna në këtë Aneks zbatohen për mallrat në bazë të klasifikimit të tyre në Sistemin e Harmonizuar si dhe mbi kritere të tjera të cilat mund të sigurohen në vijim të krerëve dhe nënkrerëve të Sistemit të Harmonizuar, të krijuar posaçërisht për qëllimet e këtij Aneksi. Një kre ose nënkre i Sistemit të Harmonizuar ndahet më tej duke përdorur kriteret e këtij Aneksi si "ndarje kreu" ose "ndarje nënkreu". "Sistemi i Harmonizuar" do të thotë Sistemi i Harmonizuar i Përshkrimit dhe Kodifikimit të Mallrave (ose shkurt "HS"), i amenduar me Rekomandimet e 26 qershorit 2009 dhe 26 qershorit 2010 të Këshillit të Bashkëpunimit Doganor.

Klasifikimi i mallrave në krerë dhe nënkrerë në Sistemin e Harmonizuar drejtohet nga rregullat e përgjithshme për interpretimin e Sistemit të Harmonizuar dhe çdo seksioni, kapitulli si dhe shënimet e nënkrerëve të këtij Sistemi. Këto rregulla dhe shënime formojnë një pjesë të Nomenklaturës së Kombinuar e cila është dhënë në Vendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave" në fuqi. Me qëllim identifikimit e një ndarjeje të saktë të krerëve ose nënkrerëve për disa mallra siç është përcaktuar në këtë Aneks, rregullat e përgjithshme për interpretimin e Sistemit të Harmonizuar dhe çdo seksion, kapitull dhe

shënim nënkreu lidhur me këtë Sistem, duhet të zbatohen *mutatis mutandis*, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe në këtë Aneks.

- 2.2. Referenca për një ndryshim në klasifikimin tarifor në rregullat bazë të paraqitura më poshtë gjejnë zbatim vetëm për materiale jo origjinuese.
- 2.3. Materialet që kanë marrë statusin e origjinës në një vend do të konsiderohen si materiale origjinuese të atij vendi për qëllim të përcaktimit të origjinës së një malli që i përmban këto materiale, ose të një malli të fabrikuar nga këto materiale përmes punimit dhe përpunimit të mëtejshëm në atë vend.
- 2.4. Kur nuk është praktike nga ana tregtare për të mbajtur stoqe të ndara materialesh të zëvendësueshme/shkëmbyeshme mallrash me origjinë nga vende të ndryshme, vendi i origjinës i materialeve të përziera që janë të zëvendësueshme/shkëmbyeshme, mund të caktohet në bazë të një metode të menaxhimit inventarizues të njohur në vendin ku materialet ose mallrat janë përzier.
- 2.5. Me qëllim zbatimin e rregullave bazë që kanë të bëjnë me ndryshimin e klasifikimit tarifor, nëse nuk specifikohet ndryshe në ndonjë Kapitull siç është përcaktuar, materialet jo-origjinuese që nuk plotësojnë rregullin bazë, nuk duhet të merren në konsideratë, me kusht që vlera totale e këtyre materialeve të mos kalojë 10 % të çmimit të fabrikës/ex-works të mallit.
- 2.6. Rregullat bazë të përcaktuara në nivel Kapitulli (rregullat bazë të kapitullit) kanë të njëjtën vlerë si rregullat bazë të paraqitura në nivel nëndarje dhe mund të zbatohen në mënyrë alternative.

3. Fjalor

Rregullat bazë në nivel nëndarje, kur bazohen në një ndryshim të klasifikimit tarifor, mund të shprehen duke përdorur shkurtimet e mëposhtme.

CC: ndryshim në kapitullin në fjalë nga çdo kapitull tjetër

CTH: ndryshim në kreun në fjalë nga çdo kre tjetër

CTSH: ndryshim në nënkreun në fjalë nga çdo nënkre tjetër ose nga çdo kre tjetër

CTHS: ndryshim në ndarje kreu në fjalë nga çdo ndarje të këtij kreu ose nga çdo kre tjetër

CTSHS: ndryshim në ndarje nënkreu në fjalë nga çdo ndarje të këtij nënkreu ose nga çdo nënkre ose kre tjetër

SEKSIONII

KAFSHËT E GJALLA; PRODUKTET SHTAZORE

KAPITULLI 2

Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit

Rregulli i mbetur i Kapitullit i zbatueshëm për përzierjet

(1) Për qëllim të këtij rregulli të mbetur, 'përzierje' do të thotë operacion i paramenduar dhe kontrolluar në mënyrë proporcionale që konsiston në përzierjen e dy, ose më shumë materialeve të zëvendësueshme.

(2) Konsiderohet vend i origjinës së një përzierje të produkteve të këtij Kapitulli vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 50% të peshës së përzierjes. Pësha e materialeve të së njëjtës origjinë do të merret si një e tërë.

(3) Nëse asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Shënim i Kapitullit:

Nëse nuk përmbyhet rregulli bazë për krerët 0201 deri në 0206, do të konsiderohet vend i origjinës së mishit (të brendshmeve) vendi në të cilin kafshët nga është përfutur ai janë majmur, apo mbarështuar për periudhën më të gjatë.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Nëse vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë dhe rregullave të tjera të mbetura të Kapitullit, vendi i origjinës së mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinojnë pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
0201	Mish gjedhëve, i freskët apo i ftohtë.	Origjina e mallrave në këtë kre do të jetë vendi ku kafsha është majmur për një periudhë të paktën tre muaj para therjes.
0202	Mish i gjedhëve, i ngrirë.	Origjina e mallrave në këtë kre do të jetë vendi ku kafsha është majmur për një periudhë të paktën tre muaj para therjes.
0203	Mish iderrave, i ftohtë apo i ngrirë.	Origjina e mallrave në këtë kre do të jetë vendi ku kafsha është majmur për një periudhë të paktën tre muaj para therjes.
0204	Mish i deleve apo dhive, i freskët, i ftohtë apo i ngrirë.	Origjina e mallrave në këtë kre do të jetë vendi ku kafsha është majmur për një periudhë të paktën tre muaj para therjes.
0205	Mish i kuajve, gomerëve, mushkave apo hibridit të gomaricës, i freskët, i ftohtë apo i ngrirë.	Origjina e mallrave në këtë kre do të jetë vendi ku kafsha është majmur për një periudhë të paktën tre muaj para therjes.

KAPITULLI 4

Produktet bulmetore; vezët e shpendëve; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë prej kafshëve, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër.

Rregulli i mbetur i Kapitullit i zbatueshëm për përzirjet:

- (1) Për qëllim të këtij rregulli të mbetur, 'përzierje' do të thotë operacion i paramenduar dhe i kontrolluar në mënyrë proporcionale që konsiston në përzirjen, ose më shumë materialeve të zëvendësueshme.
- (2) Origjina e një përzierjeje të produkteve të këtij Kapitulli do të jetë vendi i origjinës së materialeve që zënë më shumë se 50% të peshës së përzierjes; megjithatë, origjina e një përzierjeje të produkteve nga krerët 0401 deri në 0404 do të jetë vendi i origjinës i materialeve që zënë më shumë se 50% të peshës së lëndës së thatë të përzierjes. Peshë e materialeve të së njëjtës origjinë do të konsiderohet si një e tërë.
- (3) Kur asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Nëse vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë dhe rregullave të tjera të mbetura të Kapitullit, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinojnë pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 0408	- Vezët e shpendëve, jo në guackë, të thara dhe të verdhat e vezëve të thara	Origjina e mallrave do të jetë vendi ku është kryer tharja (pas thyerjes dhe ndarjes kur duhet) e: — vezëve të shpendëve, të freskëta ose të ruajtura sipas kreut S.H. ex 0407 — vezëve të shpendëve, jo në guackë, të tjera nga të thara sipas kreut S.H. ex 0408 — të verdhave të vezëve, të tjera nga të thara, sipas kreut S.H. ex 0408

SEKSIONI II

PRODUKTET VEGJETALE

KAPITULLI 9

Kafe, çaj, çaj mate dhe erëza

Rregulli i mbetur i Kapitullit i zbatueshëm për përzierjet:

- (1) Për qëllim të këtij rregulli të mbetur, 'përzierje' do të thotë operacion i paramenduar dhe i kontrolluar në mënyrë proporcionale që konsiston në përzierjen bashkë të dy, ose më shumë materialeve të zëvendësueshme.
- (2) Origjina e përzierjes së produkteve të këtij Kapitulli do të jetë vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 50% të peshës së përzierjes. Peshë e materialeve të së njëjtës origjinë do të merret si një e tërë.
- (3) Kur asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë dhe të rregullave të tjera të mbetura të Kapitullit, vendi i origjinës së mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
	- Kafe, e papjekur	
090111	- - E pa dekafeinizuar	Origjina e mallrave të këtij nënkreu do të jetë vendi nga ku mallrat janë marrë në gjendjen e tyre natyrale ose të papërpunuar.
090112	- - E dekafeinizuar	Origjina e mallrave të këtij nënkreu do të jetë vendi nga ku mallrat janë marrë në gjendjen e tyre natyrale ose të papërpunuar.
	- Kafe, e pjekur	
090121	- - E pa dekafeinizuar	CTSH

0901 22	-- E dekafeinizuar	CTSH
---------	--------------------	------

KAPITULLI 14

Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produkte vegjetale të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër

Rregulli i mbetur i Kapitullit i zbatueshëm për përzierjet:

- (1) Për qëllim të këtij rregulli të mbetur, 'përzierje' do të thotë operacion i paramenduar dhe i kontrolluar në mënyrë proporcionale që konsiston në përzierjen bashkë të dy, ose më shumë materialeve të zëvendësueshme.
- (2) Origjina e përzierjes së produkteve të këtij kapitulli do të jetë vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 50% të peshës së përzierjes. Pesha e materialeve të së njëjtës origjinë do të merret si një e tërë.
- (3) Kur asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë dhe rregullave të tjera të mbetura të Kapitullit, vendi i origjinës së mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 1404	Pushe pambuku (linters), të zbardhura	Origjina e mallrave do të jetë vendi ku produkti është prodhuar nga pambuku bruto, vlera e të cilit nuk e kalon 50% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit

SEKSIONI IV

USHQIME TË PËRGATITURA; PIJET, ALKOOLET DHE UTHULLAT, DUHANET DHE ZËVENDËSUESIT E PËRPUNUAR TË DUHANIT

KAPITULLI 17

Sheqeri dhe ëmbëlsirat prej tij

Rregulli i mbetur i Kapitullit i zbatueshëm për përzierjet:

- (1) Për qëllim të këtij rregulli të mbetur, 'përzierje' do të thotë operacion i paramenduar dhe i kontrolluar në mënyrë proporcionale që konsiston në përzierjen bashkë të dy, ose më shumë materialeve të zëvendësueshme.
- (2) Origjina e përzierjes së produkteve të këtij kapitulli do të jetë vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 50% të peshës së përzierjes. Pesha e materialeve të së njëjtës origjinë do të merret si një e tërë.
- (3) Kur asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë dhe rregullave të tjera të mbetura të Kapitullit, vendi i origjinës së mallrave do të jetë vendi nga i cili vjen pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
1701	Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri apo nga panxhar sheqeri dhe saharoza kimikisht e pastër, në gjendje të ngurtë	CC
1702	Sheqer tjetër, duke përfshirë laktozën, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra, në gjendje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lëndë aromatizuese dhe ngjyuese shtesë; mjaltë artificial, nëse është apo jo i përzier ose i papërzier me mjaltë natyral; karamel	Siç specifikohet për krerët e ndarë
ex 1702 (a)	- Laktozë, maltozë, glukozë dhe fruktozë kimikisht të pastër	CTHS
ex 1702 (b)	- Të tjera	CC
1703	Melasat e përftuara nga ekstraktimi apo rafinimi i sheqerit	CC
1704	Produkte me bazë sheqeri (duke përfshirë çokolatën e bardhë) që nuk përmbajnë kakao	CTH

KAPITULLI 20

Përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të tjera të bimëve

Rregulli i mbetur i Kapitullit i zbatueshëm për përzierjet

- (1) Për qëllim të këtij rregulli të mbetur, 'përzierje' do të thotë operacion i paramenduar dhe i kontrolluar në mënyrë proporcionale që konsiston në përzierjen, ose më shumë materialeve të zëvendësueshme.
- (2) Origjina e përzierjes së produkteve të këtij kapitulli do të jetë vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 50% të peshës së përzierjes; megjithatë, origjina e përzierjes së produkteve të kreut 2009 (lëngje frutash (duke përfshirë mushtin e rrushit) dhe lëngje zarzavatesh të pafermentuara, të cilat përmbajnë ose jo sheqer të shtuar ose lëndë tjetër ëmbëlsuese) do të jetë vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 50% të peshës së lëndës së thatë të përzierjes. Pësia e materialeve të së njëjës origjinë do të merret si një e tërë.
- (3) Kur asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 2009	Lëng rrushi	CTH, përveç mushtit të rrushit të kreut 2204

KAPITULLI 22

Pijet, alkoolet dhe uthullat

Rregulli i mbetur i Kapitullit i zbatueshëm për përzierjet

- (1) Për qëllim të këtij rregulli të mbetur, 'përzierje' do të thotë operacion i paramenduar dhe i kontrolluar në mënyrë proporcionale që konsiston në përzierjen bashkë të dy, ose më shumë materialeve të zëvendësueshme.
- (2) Origjina e një përzierjeje të produkteve të këtij Kapitulli do të jetë vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 50% të peshës së përzierjes; megjithatë, origjina e një përzierjeje të verës (kreu 2204), vermuthit (kreu 2205), alkooleve, dhe pijeve të tjera alkoolike të distiluara (kreu 2208) do të jetë vendi i origjinës së materialeve që përbëjnë më shumë se 85% të volumit të përzierjes. Pësha ose volumi i materialeve të së njëjtës origjinë do të merret si një e tërë.
- (3) Kur asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Për mallrat e këtij Kapitulli, përveç kreut 2208, kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nga zbatimi i rregullave bazë dhe rregullave të tjera të mbetura, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 2204	Verë prej rrushi të freskët për t'u përdorur për përgatitjen e vermuthit që përmban sasi të shtuar mushti nga rrushi i freskët, të përqëndruar ose jo, ose alkool	Origjina e mallrave do të jetë vendi nga është marrë rrushi në gjendjen natyrale ose të papërpunuar.
ex 2205	Vermuth	Prodhimi nga vera e rrushit të freskët që përmban musht rrushi të freskët, të përqëndruar ose jo, ose alkool, sipas kreut 2204

SEKSIONI VI

PRODUKTE TË INDUSTRIËS KIMIKE APO TË INDUSTRIVE TË LIDHJEVE

KAPITULLI 34

Sapuni, agjentët organikë me veprim sipërfaqësor, preparate larëse, preparatet lubrifikuese, dyllet artificiale, dyllet e përgatitura, preparate të pastrimit ose lustrimit, qirinjtë dhe artikujt e ngjashëm, pastat modeluese, "dyllet dentare" dhe preparatet dentare me bazë allçie

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 3401	Shajak dhe tekstile të tjera të paendura, të mbushura, veshura apo mbuluara me sapun ose detergjent	Prodhime nga shajaku ose tekstile të paendura
ex 3405	Shajak dhe tekstile të tjera të paendura, të mbushura, veshura apo mbuluara me llustrues dhe kremra, për veshjet e këmbëve, mobilje, dysheme, karroceri, xham apo metal, pasta dhe pluhura pastruese dhe preparate të ngjashme	Prodhime nga shajaku ose tekstile të paendura

KAPITULLI 35

Substancat albuminoidale; niseshtetë e modifikuara; ngjitësat; enzimmat

Rregulli i mbetur i Kapitullit

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të peshës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 3502	Albuminë veze e tharë:	Tharja (pas thyerjes dhe ndarjes, kur është e nevojshme) e: <ul style="list-style-type: none"> — vezëve të shpendëve, në guackë, të freskëta ose të konservuara, të kreut S.H., ex 0407 — vezët e shpendëve, jo në guackë, të tjera nga të thara, të kreut S.H., ex 0408 ose — të bardhat e vezëve, të tjera nga të thara, të kreut S.H. ex 3502

SEKSIONI VIII

LËKURËT E PAPËRPUNUARA, LËKURËT E PËRPUNUARA, GËZOFËT DHE ARTIKUJT E TYRE; TAKËMET DHE PAJIMET E KUAJVE; MALLRAT E UDHËTIMIT, ÇANTAT E UDHËTIMIT DHE KONTENIERËT E NGJASHËM; ARTIKUJ NGA TË BRENDSHMET E KAFSHËVE (PËRVEÇ ATYRE NGA FSHIKËZAT E KRIMBIT TË MËNDAFSHIT)

KAPITULLI 42

Artikujt prej lëkure; takëmet dhe samarët e kalit; mallrat e udhëtimit, çantat e dorës dhe kontenierë të ngjashëm; artikuj nga të brendshmet e kafshëve (përveç atyre nga fshikëza e krimbit të mëndafshit)

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
-------------------	-----------------------	---------------

ex 4203	- Artikuj të veshjes prej lëkure ose prej lëkurës së kompozuar	Konfeksionim i plotë
---------	--	----------------------

SEKSIONI X

BRUMI I DRURIT OSE I MATERIALEVE TË TJERA FIBROZE CELULOZIKE; LETËR OSE KARTON I RICIKLUESHËM (MBETJE DHE SKRAPE); LETËR DHE KARTON SI DHE ARTIKUJT PREJ TYRE

KAPITULLI 49

Librat, revistat, gazetat, fotografitë dhe produktet e tjera të industrisë së shtypit; dorëshkrimet, shtypshkrimet dhe projektet

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendinë të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 4910	Kalendarë qeramike të çdo lloji, të printuar, duke përfshirë blloqe kalendarësh, të dekoruar.	CTH

SEKSIONI XI

TEKSTILET DHE ARTIKUJT E TEKSTILEVE

KAPITULLI 50

Mëndafshi

Shënim i Kapitullit

Termostampimi duhet të jetë i shoqëruar me printimin e letrës transferuese në mënyrë që të japë origjinë.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve siç është përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5001	Fshikëza të krimbit të mëndafshit të përshtatshme për t'u mbështjellë në bobinë	CTH
5002	Mëndafsh i papërpunuar (jo i përpunuar).	CTH
5003	Mbetje mëndafshi (duke përfshirë fshikëzat e papërshtatshme për t'u mbështjellë në bobinë, mbetje fijesh dhe të hequra prej pëlhurave).	CTH

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5004	Fill mëndafshi (të tjera nga fije të tjerrura nga mbetjet e mëndafshit) jo për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrale jo të krehura ose të gërhanura ose ndryshe të përgatitura për tjerje, — mëndafsh i papërpunuar ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerje <p>Ose</p> <p>Stampimi ose lyerja e fillit ose monofilamentëve, të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruara nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohet si i tillë, vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës /ex-works të produktit.</p>
5005	Fill mëndafshi nga mbetjet e mëndafshit, jo për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrale jo të krehura ose të gërhanura ose ndryshe të përgatitura për tjerje, — mëndafsh i papërpunuar ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerje <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit ose monofilamentëve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohet si i tillë, vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>
5006	Fill mëndafshi dhe fill i tjerrur nga mbetjet e mëndafshit, për shitje me pakicë; fije të forta nga fshikëza të krimbit të mëndafshit.	Siç specifikohet për krerë të ndarë
ex 5006 (a)	Fije të forta nga fshikëza të krimbit të mëndafshit	CTH

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 5006 (b)	Të tjera	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrale jo të krehura ose të gërhanura ose ndryshe të përgatitura për tjerje, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerje <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit ose monofilamentëve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohet si i tillë, vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>
5007	Pëlhura të endura nga mëndafshi ose nga mbetjet e mëndafshit	<p>Prodhime nga filli</p> <p>ose</p> <p>Stampimi ose ngjyrimi i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruara nga operacione përgatitore ose të përfundimit.</p>

KAPITULLI 51

Leshi, qime të holla ose të ashpra kafshësh; fije nga flokët e kalit dhe pëlhura të endura prej tyre

Shënim i Kapitullit

Termostampimi duhet të jetë i shoqëruar me printimin e letrës transferuese në mënyrë që të japë origjinë.

Rregulli i mbetur i Kapitullit:

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi SH. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5101	Lesh, jo i krehur ose i gërhanur	Siç specifikohet për krerë të ndarë

Kodi SH. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
ex 5101 (a)	-Me yndyrë, përfshi leshin e larë në trupin e bagëtisë	CTH
ex 5101 (b)	- i çyndyrosur, i pakarbonizuar	Prodhim nga leshi me yndyrë, duke përfshirë edhe mbetjet, vlera e të cilit nuk e kalon 50% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.
ex 5101 (c)	- i karbonizuar	Prodhim nga lesh i çyndyrosur, jo i karbonizuar, vlera e të cilit nuk e kalon 50% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.
5102	Qime të holla apo të ashpra kafshësh, jo të krehura apo të gërhanura.	CTH
5103	Mbetje të leshit apo qimeve të holla apo të ashpra të kafshëve, duke përfshirë mbetje fijesh por duke përjashtuar fijet e hequra nga pëlhura	Siç specifikohet për krerë të ndarë.
ex 5103 (a)	të karbonizuara	Prodhime nga mbetje jo të karbonizuara, vlera e të cilave nuk kalon 50% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit
ex 5103 (b)	të tjera	CTH
5104	Fije të hequra nga pëlhura prej leshi ose prej qimeve të holla ose të ashpra të kafshëve.	CTH
5105	Lesh dhe qime të holla ose të ashpra kafshësh, të krehura ose të gërhanura (përfshirë edhe leshin e gërhanur në copa).	CTH
5106	Fill prej leshi të gërhanur, jo të vendosur për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura për tjerje, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerje <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit ose monofilamentëve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-originues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit</p>

Kodi SH. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5107	Fije leshi të krehur, jo për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit ose monofilamentëve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>
5108	Fill prej leshrave speciale (të gërhanura apo të krehura), jo të vendosura për shitje me pakicë:	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit ose monofilamentëve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>

Kodi SH. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5109	Fill prej leshi apo prej leshrave speciale, të vendosur për shitje me pakicë:	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit ose monofilamentëve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>
5110	Fill prej qimeve të ashpra të kafshëve apo prej qimeve të kalit (përfshirë fillin e përdredhur prej qimeve të kalit), nëse janë apo jo të vendosura për shitje me pakicë	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit ose monofilamentëve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar, nga operacionet përgatitore ose të përfundimit, përdredhja ose teksturimi që nuk konsiderohen si të tilla, vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>
5111	Pëlhura të endura prej leshi të gërhanura apo prej leshrave speciale të gërhanura.	<p>Prodhim nga filli</p> <p>Ose</p> <p>Stampimi apo ngjyrimi i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit</p>
5112	Pëlhura të endura prej leshi të krehur apo prej leshrave speciale të krehura.	<p>Prodhim nga filli</p> <p>Ose</p> <p>Stampimi apo ngjyrimi i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit</p>

Kodi SH. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5113	Pëlhura të endura prej qimeve të ashpra të kafshëve apo prej qimeve të kalit.	Prodhim nga fijet Ose Stampim apo ngjyrim i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit

Kapitulli 52

Pambuku

Rregulli i mbetur i Kapitullit

Kur vendi i originës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i originës i mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5201	Pambuk, jo i gërhanur apo i krehur.	Siç specifikohet për krerë të ndarë.
ex 5201 (a)	i zbardhur	Prodhim nga pambuku i papërpunuar, vlera e të cilit nuk kalon 50% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit
ex 5201 (b)	të tjera	CTH
5202	Mbetje pambuku (përfshirë mbetje fijesh dhe ato të hequra nga pëlhurat).	CTH
5203	Pambuk, i gërhanur apo i krehur.	CTH

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5204	Penj pambuku për qepje, nëse janë vendosur apo jo për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura apo të gërhanura, apo -ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampimi apo ngjyrimi i fillit ose monofilamenteve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-originues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës /ex-works të produktit.</p>
5205	Fill pambuku (ndryshe nga pe për qepje), që përmban 85 % apo më shumë ndaj peshës pambuk, jo i vendosur për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura apo të gërhanura, apo ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampimi ose ngjyrimi i fillit, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, thurje që nuk konsiderohen si të tilla, vlera e materialit jo-originues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5206	Fill pambuku (ndryshe nga pe për qepje), që përmban 85 % më pak ndaj peshës pambuk, jo i vendosur për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura apo të gërhanura, apo ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampimi apo ngjyrimi i fillit ose monofilamenteve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës /ex-works të produktit</p>
5207	Fill pambuku (ndryshe nga pe për qepje), i vendosur për shitje me pakicë	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura apo të gërhanura, apo ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampimi apo ngjyrim i fillit ose monofilamenteve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës /ex-works të produktit</p>
5208	Pëlhura të endura prej pambuku që përmbajnë ndaj peshës 85% apo më shumë pambuk, me peshë jo më shumë se 200 g/ m ² .	<p>Prodhim nga filli</p> <p>Ose</p> <p>Stampimi apo ngjyrimi i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit</p>

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5209	Pëlhura të endura prej pambuku që përmbajnë ndaj peshës 85% apo më shumë pambuk, me peshë më shumë se 200 g/m ² .	Prodhim nga filli Ose Stampim apo ngjyrim i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit
5210	Pëlhura të endura prej pambuku, që përmbajnë ndaj peshës më pak se 85 % pambuk, të përzier kryesisht apo vetëm me fibra sintetike ose artificiale, me peshë jo më shumë se 200 g/m ² :	Prodhim nga filli Ose Stampim apo ngjyrim i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit
5211	Pëlhura të endura prej pambuku, që përmbajnë ndaj peshës më pak se 85% pambuk, të përzier kryesisht apo vetëm me fibra sintetike apo artificiale, me peshë më shumë se 200 g/m ² .	Prodhim nga filli Ose Stampim apo ngjyrim i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit
5212	Pëlhura të tjera të endura prej pambuku.	Prodhim nga filli Ose Stampim apo ngjyrim i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit

KAPITULLI 53

Fibra të tjera tekstile vegjetale; fill letre dhe pëlhura të endura prej fillit të letrës

Rregulli i mbetur i Kapitullit

Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës së mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5301	Liri, i papërpunuar apo i përpunuar por jo i dredhur; fibra të shkurtra liri dhe mbetje (përfshirë mbetje filli dhe ato të hequra prej pëlhurave)	CTH
5302	Kërp (<i>Cannabis sativa L.</i>), i papërpunuar apo i përpunuar por jo i dredhur; fibra të shkurtra ose mbetje të kërpit (përfshirë mbetjet e fijeve dhe ato nga heqja e fijeve prej pëlhurave)	CTH

Kodi S.H 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5303	Juta dhe fibra të tjera bimore tekstili (përjashto lirin, kërpin dhe ramie), të papërpunuara apo të përpunuara por jo të dredhura; fibra të shkurtra dhe mbetje të këtyre fibrave (përfshirë mbetjet e fijeve dhe ato nga heqja e fijeve prej pëlhurave).	CTH
[5304]		
5305	Fibra të arrës së kokosit, abaka (kërp i Manilës apo "Musa textilis Nee"), ramie dhe fibra të tjera tekstile vegetale, të paspecifikuara dhe të papërfshira diku tjetër, të papërpunuara apo të përpunuara por jo të dredhura; fibra të shkurtra dhe mbetje të këtyre fibrave (përfshirë mbetjet e fijeve dhe ato të hequra prej pëlhurave	CTH
5306	Fill liri.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura, ose ndryshe të përgatitura për tjerje, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra artificiale ose sintetike shtapel, jo të krehura ose të gërhanura të përgatitura për tjerje <p>Ose</p> <p>Stampimi ose ngjyrimi i fillit, ose monofilamenteve të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo-origjinues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>

Kodi S.H 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5307	Fill jute apo i fibrave të tjera tekstilësh bimore të kreut 5303.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura përthurje, — mëndafsh i papërpunuar, ose mbetje mëndafshi — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra sintetike apo artificiale shtapel, jo të krehura ose të gërhanura ose ndryshe të përgatitura për tjerje <p>Ose</p> <p>Stampimi ose ngjyrimi i fillit, ose monofilamenteve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo - origjinues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit.</p>
5308	Fill prej fibrave të tjera tekstile vegjetale; fill letre.	Siç specifikohet për krerë të ndarë.
ex 5308 (a)	- Fill prej fibrave të tjera tekstile vegjetale	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrore jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura përthurje, — mëndafsh i papërpunuar apo mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra sintetike ose artificiale shtapel, jo të krehura apo të gërhanura të përgatitura për tjerje <p>Ose</p> <p>Stampimi ose ngjyrimi i fillit ose filamenteve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo origjinues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës/ ex-works të produktit.</p>
ex 5308 (b)	- fill letre	CTH
5309	Pëlhura të endura prej liri.	<p>Prodhim nga filli</p> <p>Ose</p> <p>Stampimi ose ngjyrimi i pëlhurave të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruara nga operacione përgatitore ose të përfundimit</p>

Kodi S.H 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5310	Pëlhura të endura prej jute apo prej fibrave të tjera tekstile bimore të kreut 5303.	Prodhim nga filli Ose Stampimi ose ngjyrimi i pëlhurave , të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruara nga operacione përgatitore ose të përfundimit
5311	Pëlhura të endura prej fibrave të tjera tekstile vegetale; pëlhura të endura prej fillit të letrës.	Siç specifikohet për krerë të ndarë.
ex 5311 (a)	Pëlhura të endura prej fibrave të tjera tekstile vegetale	Prodhim nga filli Ose Stampimi ose ngjyrimi i pëlhurave , të pazbardhura ose të zbardhura, të shoqëruara nga operacione përgatitore ose të përfundimit
ex 5311 (b)	Pëlhura të endura prej filli të letrës.	CTH

KAPITULLI 54

Filamentet sintetike dhe artificiale; shiritat dhe të ngjashmet me to të materialeve tekstile sintetike ose artificiale

Rregulli i mbetur i Kapitullit

Kur vendi i originës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i originës së mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve.

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
5401	Fill për qepje prej filamenteve artificiale ose sintetike, nëse është vendosur apo jo për shitje me pakicë.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrale jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar apo mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra sintetike ose artificiale shtapel, jo të krehura apo të gërhanura të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampimi ose ngjyrimi i fillit ose filamenteve, të pazbardhur ose të zbardhur, të shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo origjinues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës/ ex-works të produktit</p>
5402	Fill sintetik filament (të tjera nga pe për qepje), jo të vendosur për shitje me pakicë, përfshirë monofilamentet sintetike prej më pak se 67 decitex.	<p>Prodhim nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> — fibra natyrale jo të krehura ose të gërhanura ndryshe të përgatitura për tjerre, — mëndafsh i papërpunuar apo mbetje mëndafshi, — materiale kimike ose pulp tekstili, ose — fibra sintetike ose artificiale shtapel, jo të krehura apo të gërhanura të përgatitura për tjerre <p>Ose</p> <p>Stampim ose ngjyrim i fillit, i pazbardhur ose i zbardhur, i shoqëruar nga operacione përgatitore ose të përfundimit, përdredhja apo teksturimi të cilat nuk konsiderohen si të tilla, ku vlera e materialit jo origjinues (duke përfshirë fillin), nuk i kalon 48% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit</p>

Kodi S.H. 2012	Përshkrimi i mallrave	Rregulla bazë
